

RAPORT
MONITORIMI

Prill 2022

Infermierët e rinj, eksportojmë aq sa diplomojmë!



AUTOR
STIVEN SHALA

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

Konteksti

Emigrimi i mjekëve dhe infermierëve është një fenomen që në vendin tonë njihet që pas rënies së komunizmit. Sot, largimi i personelit shëndetësor ka marrë formë dhe përmasa të reja duke bërë që Shqipëria të vazhdojë të humbasë gjithnjë e më tepër mjekë dhe infermierë. Situata kohët e fundit është alarmante, e megjithatë duket se do bëhet më keq.

Qëndresa Qytetare i drejtoi një kërkesë për informacion Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë për të parë se sa Infermier dhe Infermier-Mami ishin pajisur me dokumentacion për tu larguar. Periudha e marrë në shqyrtim ishte 2016-2021. Për Infermierët, në vitin 2016, vetëm 67 persona ishin pajisur me dokumentacion. Në vitin 2017 vetëm 131. Në 2018, 211. Në 2019, 417. Në 2020, 614. Ndërsa, në vitin 2021 plot 1073 infermierë ishin pajisur me dokumentacionin për largim.



Për Infermierët-Mami ndërkohë nga viti 2016 deri në 2018, asnjë person nuk ka kërkuar dokumentacionin për largimin. Nga viti 2019 fillojnë kërkesat - me 17 persona për këtë vit. Për 2020, 58. Ndërsa për 2021, 138 persona. Pra edhe Infermierët - Mami, të cilët nuk ishin prekur nga ky fenomen deri para

disa viteve, kanë filluar të largohen. Në vitin 2018, Urdhri i Infermierit u përfshi në një debat me portalet pasi në media u përhap një lajm se nga 2000 në 4000 infermierë kishin kërkuar dokumenta për jashtë vendit.¹


 REPUBLIKA E SHqipëRIË
 URDHRI I INFERMIERIT TË SHqipëRIË

No. 266/Prot. Tiranë, më 06/04/2022

Lënda: Këhim përgjigje
Drejtuar: Qëndresa Qytetare

Në përgjigje të shkronës Tsjj, datë 24/03/2022, mbas verifikimit të dokumentacionit të UISH rezultoi që nga viti 2016 deri në vitin 2021 për profesionist infermier dhe infermier-mami që janë pajisur me dokumentacion për të larguar rezultojt:

VITI	NR. INFERMIER	NR. INFERMIER-MAMI
2016	67	0
2017	131	0
2018	211	0
2019	417	17
2020	614	58
2021	1073	138


 PRESIDENTI I UISH
 BULEVARI DUKA

Në deklaratën e Urdhrit të atij viti, shprehej qartë se në 2018, 750 profesionistë kishin kërkuar dokumenta për jashtë, ndërkohë në përgjigjen për kërkesën tonë për informacion, Urdhri na dha shifrën 211. Sipas analizës së numrit të kuotave për student të degës Infermieri vërehet se Shqipëria po eksporton pothuajse aq studentë sa po përgatit çdo vit.

Për vitin akademik 2019-2020, numri i kuotave për degën Infermieri e Përgjithshme ishte 1163.


¹ <https://www.balkanweb.com/infermieret-po-largohen-jashte-vendit-cfare-thote-urdhri/>

Për vitin akademik 2020-2021, numri i kuotave për degën Infermieri e Përgjithshme ishte 1319, ku 896 kuota janë në universitetet publike dhe 423 në universitetet private.

Qëndresa Qytetare zhvilloi një anketë më studentët e Infermierisë së Përgjithshme dhe Infermieri-Mamisë në dy universitete – Universitetin e Shkodrës dhe Universitetin e Vlorës për të parë perspektivën e studentëve mbi studimet që ndjekin dhe të ardhmen që i pret.


Plot 165 studentë nga vite të ndryshme studimi si dhe të diplomuar u bënë pjesë e kësaj ankete.

Në cilin vit të studimeve jeni?



Të pyetur nëse ishin të kënaqur me cilësinë e studimeve, vetëm 5% e studentëve thanë jo. 52% e të anketuarve u shprehën të kënaqur me cilësinë e studimeve ndërsa 41% disi të kënaqur. Këto shifra pozitive tregojnë se studentët janë më të interesuar për diplomën, e cila i shërben për t'u larguar dhe nuk interesohen për zhvillimin cilësor akademik e profesional.

A jeni të kënaqur me cilësinë e studimeve që po ndjekni




Studentët u pyetën edhe nëse donin të ndryshonin diçka në studimet që ndjekin. Disa nga përgjigjet përfshinin:

- Mënyrën e vlerësimit dhe testimit
- Përzgjedhjen e literaturës
- Praktika profesionale nga të cilat studentët përfitojnë
- Kushte më të mira për mësimin duke filluar nga ambientet e studimit, kabinetet
- Përqendrimi i vlerësimit akademik tek aftësitë profesionale
- Korrektesën nga ana e pedagogëve
- Korrupsionin

Fakti që studentët janë të aftë të rreshtojnë një sërë problemesh të tilla, tregon se në të vërtetë ato nuk janë të kënaqur me studimet që po ndjekin. Mungesa e korrektesës dhe korrupsioni duket se vazhdojnë të jenë akoma problem në sistamin tonë universitar.

Për të përforcuar më shumë largimin e infermierëve nga Shqipëria dhe marrjen e diplomës për ta përdorur si biletë largimi, vetëm 14.5% e të anketuarve e shikonin të ardhmen e tyre në Shqipëri. Pothuajse gjysma e studentëve e shohin të ardhmen në një vend tjetër, ndërsa po aq janë të pavendosur për sa i përket të ardhmes së tyre. Ndërkohë janë të shumta qendrat të cilat rekrutojnë studentë për vendet e Bashkimit Evropian si Gjermania, Italia, Franca apo Suedia.

A e shikoni të ardhmen tuaj në Shqipëri?




Studentët e dinë mjaft mirë gjendjen e sistemit tonë shëndetësor, duke qenë se ato e prekin vetë çdo ditë në praktikat e tyre profesionale pranë strukturave spitalore. Një student e sheh vetë si një profesionist vuan çdo ditë dhe nuk arrin ta shijojë atë çfarë për të cilën ka investuar, një të ardhme të qetë e të sigurt.

Largimi si arsye kryesore kishte të ardhurat (financat) ku 35% e studentëve shprehen se do e konsideronin ushtrimin e profesionit në një vend tjetër. Pas

financave, 25.5% e studentëve vlerësojnë cilësinë më të lartë të jetesës në vendin ku largoheshin dhe 23.6% vlerësojnë kushtet më të mira të punës.


Cilat janë dy arsyt kryesore për të cilat ju do e konsideroni ushtrimin e profesionit në një vend tjetër?



Ndërkohë studentët duken të ndarë kur pyeten nëse infermieri është një figurë e vlerësuar në Shqipëri. 15.2% mendojnë se infermieri është një figurë e vlerësuar, 51.5% besojnë se infermieri vlerësohet disi, ndërsa 33.3% thonë se infermieri nuk vlerësohet në Shqipëri.

Këtë perceptim studentët e kanë ndërtuar gjatë viteve të studimit si dhe praktikave profesionale, pasi çdo ditë ato shohin se si personeli shëndetësor përballet me fyerje, presion apo edhe dhunë.

A mendoni se infermieri është një figurë e vlerësuar në Shqipëri?



Edhe pse në një krizë pandemie, plot 614 infermierë shqiptarë zgjodhën të largohen në vitin 2020. Ndërkohë që situata vjen dhe qetësohet në vitin 2021, numri pothuajse dyfishohet. Me mbarimin e situatës së pandemisë Covid-19, pritet një tjetër valë largimi.

Qëndresa Qytetare iu drejtua Urdhrit të Infermierit me një kërkesë për informacion për të parë si qëndron mosha mesatare e infermierëve në Shqipëri.

Sipas regjistrimit kombëtar të Urdhrit të Infermierëve të Shqipërisë, mosha mesatare e infermierëve të regjistruar në vendin tonë, është 43 vjeç. Ndërsa mosha mesatare e infermier-mami është 38 vjeç.



Këto të dhëna janë pozitive pasi tregojnë që në Shqipëri ka akoma profesionistë shëndetësor, sidomos duke pasur parasysh që mosha mesatare e mjekëve të regjistruar në vendin tonë, është 45 vjeç. Ndërsa mosha mesatare e mjekëve specialistë është 50 vjeç.

Sipas dokumentacionit të Urdhrit, në Shqipëri janë 23 866 infermierë të liçensuar. Pyetja qëndron tek fakti nëse Urdhri tek kjo e dhënë përfshin edhe infermierët e larguar..

Ndërsa, kur Urdhri pyetet për numrin e infermierëve që janë në pritje të punësimit dhe sa janë të punësuar, ato shprehen se të dhënat duhet të merren nga Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor.

Ndërkohë, deri në vitin 2018, Udhri i dispononte këto të dhëna pasi në deklaratën që cituam më parë institucioni shprehej – “Për ne, lëvizja e infermierëve jashtë shtetit nuk përbën shqetësim, pasi sipas regjistrimit tonë ne kemi sot rreth 6500 infermierë të licencuar në pritje për punësim dhe çdo vit, kjo shifër rritet, pasi nga shkollat tona dalin çdo vit 1000-1200 profesionistë.”

Të dhënat që vijnë nga ky raport, apo edhe nga raporte të tjera janë shumë shqetësuese, e megjithatë nuk shihet se frenimi i këtij fenomeni është prioritet nga qeveria.

Sistemi shëndetësor është një e mirë publike, një pasuri kombëtare dhe si i tillë meriton një vëmendje të shtuar, sidomos në kushtet në të cilat gjendet. Pandemia na tregoi se si sistemi ynë shëndetësor është i brishtë, me mungesa në infrastrukturë e në personel të specializuar. Edhe pse situata epidemiologjike në vend sot është më mirë, Shqipëria nuk mund të rrezikojë të vazhdojë të gjendet e papërgatitur për kriza të tilla shëndetësore. Për më tepër, garantimi i shërbimit shëndetësor, për çdo qytetar, pavarësisht a jeton në Tiranë apo në fshatrat me të thella, është detyrë e shtetit.

Shërbimi shëndetësor nuk duhet të mungojë për asnjë arsye, e sidomos kur arsyeja është mungesa e personelit atëherë faji bie direkt mbi drejtuesit e shëndetësisë të të gjitha viteve, të cilët me qëllim, apo jo, e kanë shkatërruar të ardhmen e shëndetësisë në vend.

GJETJET KRYESORE



Vetëm për vitin 2020 dhe 2021, **1687 infermierë kanë kërkuar çertifikatën e sjelljes së mirë** nga Urdhri i Infermierit, dokument ky që nevojitet për t'u bërë pjesë e sistemit shëndetësor të një vendi tjetër.



Në anketën e realizuar me studentë të degës së Infermierisë, **52% e të anketuarve ishin të kënaqur me cilësinë e studimeve që po ndjekin si dhe vetëm 5% e studentëve shprehin pakënaqësi.**



Të pyetur për të ardhmen e tyre si infermierë në Shqipëri, **vetëm 14.5% e të anketuarve e shikonin të ardhmen në Shqipëri.**



Largimi si arsye kryesore ka të ardhurat ku 35% e studentëve shprehen se do e konsideronin ushtrimin e profesionit në një vend tjetër. Pas financave, 25.5% e studentëve vlerësojnë cilësinë më të lartë të jetesës në vendin ku largoheshin dhe 23.6% vlerësojnë kushtet më të mira të punës.



Shqipëria ka sot 23 866 infermierë të liçensuar. Moshë mesatare e infermierëve në Shqipëri është 43 vjeç. Ndërsa moshë mesatare e mjekëve specialistë është 50 vjeç.

REKOMANDIMET



Ndërhyrja e menjëhershme në sistemin shëndetësor, duke e vlerësuar këtë sistemi si një e mirë publike e përbashkët, për t'i shëruar plagët disa-vjeçare me qëllim ndalimin e shkatërrimit të mëtejshëm.



Duke qenë se largimi i personelit shëndetësor vjen si pasojë e një kompleksiteti faktorësh, duhet të nisët një debat publik, me analiza konkrete duke përfshirë të gjithë palët e interesuara për të adresuar çdo shqetësim të personelit shëndetësor.



Përmirësimi i kushteve qoftë për infermierin apo edhe për studentët e infermierisë, duke nisur me infrastrukturën e strukturave arsimore e shëndetësore, apo edhe me përmirësimin e cilësisë së zhvillim akademik e projekte me impakt real në formimin e mëtejshëm.

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

